VENDIM
Nr.15, datë 6.3.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ALB WIND ENERGY" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARQET EOLIK VISU DHE TERPAN) SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë Elektrike nga burimet e rinovueshme", neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "ALB WIND ENERGY" sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolik Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë "ALB WIND ENERGY" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolike Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta